

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA
BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO


Sistemi i Pagesave në Kosovë

Prishtinë, 2004

Sistemi i Ndërbankar i Pagesave

Me vendimin për të mbyllur rrjetin e degëve të saj, në vitin 2002, BPK-ja përfundoi aktivitetet e tij komerciale. Evolucioni në tranzicion nga aktivitetet komerciale (të sektorit jo-financiare) në aktivitete tradicionale (sektorit financiar) të kryera nga BPK-ja mund të vërehet nga figura më poshtë:


Figure 10. Zhvillimi i Sistemit të Pagesave



Në vitin 2003, BPK-ja ka vazhduar me përpjekjet e saj për të zhvilluar para bankare në Kosovë. Progresi i bërë në këtë drejtim mund të vlerësohet nga të dhënat që përshkruajnë zhvillimin e depozitave me bankat komerciale, dhe operacionet e kliringut ndërbankar.

Figura e mëposhtme tregon përmirësim në strukturën e depozitave dhe rritjen e besimit në rritje në sektorin bankar.

Figure 11. Zhvillimi i depozitave të bankave komerciale



Në vijim të tranzicionit gradual drejt operacioneve bankare pa para të gatshme dhe rënies së nevojë për para të gatshme, rëndësia e një sistemi efikas të Kliringut Ndërbankar u bë shumë më e qartë.

BPK-ja jo vetëm që menaxhon dhe monitoron operacionet, por po ashtu merr pjesë drejtpërdrejtë në Sistemin e Kliringut Ndërbankar (SKN), ku të gjithë shtatë bankat komerciale janë anëtare. Procedurat e kliringut dhe shlyerjes janë definuar duke u bazuar në Rregullën nr. XVIII të BPK-së dhe në Rregulloren mbi Transaksionet e Pagesave nr. 2001/26.


Katër banka komerciale duke përfshirë edhe vetë BPK-në kanë përmirësuar pjesëmarrjen në SKN përmes implementimit të lidhjes automatike mes serverëve të tyre (sistemit të kontabilitetit) dhe serverëve të SKN-së, gjatë vitit 2003.

Numri i transaksioneve të procesuara përmes sistemit ndërbankar të kliringut është rritur në mënyrë të qëndrueshme që tregon për rikthimin e besueshmërisë së qytetarëve të Kosovës në industrinë bankare.

SKN-ja ka filluar me 4,888 transaksione (EUR 79,535,000.00) në vitin 2001 dhe 75,763 transaksione (EUR 840,605,000,00) në vitin 2002, ndërsa në vitin 2003 numri i përgjithshëm i transaksioneve arriti në 164,207 (EUR 1,416,118,928.28).

Në vitin 2003, numri mesatar i transaksioneve për muaj arriti në 655 transaksione (vlera mesatare EUR 5,619,519), dhe kjo paraqet rritje prej 128 për qind në numër dhe 68 për qind në vlerë, krahasuar me mesataren në vitin 2002.

Figure 12: Zhvillimi i operacioneve të SKN në vitin 2003



Tarifat e ngarkuara nga SKN-ja, si për anëtarësim dhe transaksione, ka mbetur e pandryshuar gjatë vitit. Përveç pagesave normale (transfereve bankë-bankë) dhe prioritare (numri i vogël i transfereve individuale) SKN filloj të përfshijë edhe pagesat masive. Pritet që moduli i paghesave masive të finalizohet dhe të filloj të zbatohet gjatë vitit 2004.

Përmes Departamentit të shërbimeve bankjare, BPK-ja ka zhvilluar marrëdhënie të mira me të gjithë klientët e saj, në veçanti me Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), që synojnë drejt optimizmin e mëtejshëm të sistemit të pagesave. BPK-ja ka përmirësuar shërbimet për klientët e saj (institucionet financiare dhe qeveritare) me të gjitha nevojat e tyre (trajtimin e urdhërpagesave, pasqyrat e llogarive, hapjen dhe mbylljen e llogarive etj). Sa për këto aktivitete në vitin 2003, BPK-ja ka procesuar 76.309 urdhërpagesa dalëse (pagesa në emër të klientëve të BPK) dhe 35.650 urdhërpagesa hyrëse (fondeve të pranuar për klientët e BPK). Shprehur në vlerë, shuma e pagesave dalëse në 2003 arriti në 578 mil. euro, ndërsa shuma e pagesave hyrëse ishte 686 mil. euro.